



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të

AC-I-16-0165

Ankuesi/paditësi

ATK, Prishtinë

Kundër:

I padituri

Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP), Rruga, Agim Ramadani 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-3301 të datës 07/07/2016 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2019 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-3301 i datës 07/07/2016.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 26 nëntor 2013 ankuesi ATK, në Prishtinë, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashtroi, ankesë kundër vendimit nr. PEJ089-0020, i datës 04.11.2013 të lëshuar nga AKP në Prishtinë - Autoriteti i likuidimit (më tutje AL) për Ndërmarrjen Shoqërore "Z", nga Peja (në likuidim), me të cilin pjesërisht ishte pranuar kërkesa për borgjin e pa paguar tatimor në shumën prej 6.679,65 euro, ndërsa ishte refuzuar për shumën prej 16,412.67 euro me arsyetim se kjo shumë e llogaritur e interesit tejkalonte 10% e lejuar nga neni 37.3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Me datë 13 qershor 2014, AKP, Dhomës së Posaçme i ka parashtruar mbrojtjen ndaj kësaj anekese duke propozuar që anekesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi me arsyetim se Kolegji i Specializuar saktësisht kishte zbatuar dispozitën e nenit 37.3 të Shtojcës.

Me datë 24 korrik 2014 ankuesi në Dhomën e Posaçme ka parashtruar përgjigjen e tij në mbrojtjen e dërguar nga AKP, duke e kundërshtuar në tërësi mbrojtjen e dhënë nga AKP-ja dhe Dhomës së Posaçme i propozon që ta anuloj vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe ta aprovoj anekesën si të bazuar.

Në kundërpërgjigjen e dhënë në përgjigjen e ankuesit AKP me datë 26 gusht 2014 ka mbetur në tërësi sipas mbrojtjes së parashtruar më herët në Dhomën e Posaçme duke i propozuar Dhomës së Posaçme që anekesa e ankuesit të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i autoritetit të likuidimit.

Më 07/07/2016, Kolegji i Specializuar nxori Aktgjykim, C-IV-13-3301 me të cilin refuzoi , anekesën si të pa bazuar dhe vërtetoi, vendimin e AL. nr. PEJ089-0020 i datës 04/11/2013. Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se anekesa e paditësit është e pabazuar pasi që shumta e kërkuar nga ankuesi për interes, tejkalon 10% e lejuar nga Shtojca Ligjit për AKP-në nr. 03/L-034 i cili Ligj, meqenëse është special (lex

specialis) mbizotëron ndaj Ligjit mbi Administratën Tatimore si dhe ndaj cilit do ligj tjetër në Kosovë.

Me datë 26/07/2016, e paditësi, (më tutje ankuesi) dorëzon një ankesë ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar C-IV-13-3301 të datës 07/07/2016, (me tej Aktgjykimi i ankimuar) të cilin Aktgjykim e konteston dhe mbi baza të meritës.

Ankuesi pretendon se Kolegji i Specializuar gabimisht ka konstatuar se Ligji i APK-nr. 04/L-034 është Ligj Special dhe bazuar në parimin "lex specialis derogate lex gjenerali" mbizotëron ndaj çdo Ligji tjetër. Më tutje ankuesi pohoi se legjislacioni që rregullon fushën tatimore është gjithashtu Ligj special për fushën e tatimeve dhe duhet të mbizotërojë ndaj çdo Ligji tjetër. Andaj i propozon Kolegjit të Apelit aprovimin e ankesës si të bazuar dhe kthimin e lëndën në rigjykim apo të aprovojë në tërësi kërkesën e Administratës Tatimore Lidhur me detyrimet e NSH-së "Z"

Në përgjigjen e vetë të datës 25/08/2016, AKP-ja pohoi se argumentet e ankuesit janë të pabazuara dhe Aktgjykimi ankimor i Kolegjit të Specializuar dhe vendimi i autoritetit të Likuidimit duhen të vërtetohen. AKP-ja ka pohuar se qëndron pranë thënieve të paraqitura në mbrojtën dhe kundërpërgjigjen e vetë para Kolegjit të Specializuar.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Bazuar në nenin 69.1 të Ligjit Nr.06/L086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendosi ta përjashtojë pjesën gojore nga procedura.

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet vërtetuar.

Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesës, provave të bashkangjitura dhe shkresave tjera të kësaj lëndë të mbledhura gjatë procedurës me shkrim, konstaton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Aktgjykimi i atakuar është i drejtë, i bazuar, i arsyetuar mirë, nuk përmban zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Specializuar saktësisht ka konstatuar se Ligji i AKP-së, nr. 03/L-034 si ligj Special i cili, fushë-veprim të vetë ka vetëm, Ndermarrjet shoqërore, mbizotron ndaj çdo ligji tjetër sikundër edhe ndaj Ligjit të Administratës Tatimore të Kosovës. Këtë e parashef edhe neni 31 i Ligjit nr. 03/L-034 i AKP-së, paragrafi 1, "Ky ligj mbi sundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të".

Në bazë të këtyre arsyeve ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më lartë e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore pasi që ankuesi tashmë e ka paguar taksën me datë 15/08/2016.

Vendosur nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS më 26 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT

Ju lutem dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Palët
- Gjyqtari Kryesues i Kolegjit të Specializuar në lëndën numër C-IV-13-3301.

Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues
